



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA PEQIN

DREJTORIA E ARSIMIT KULTURES SPORTIT DHE TRASHEGIMNISE KULTURORE

Nr. ____ Prot.

Peqin, më 16.,02,2024.

PROJEKT VENDIM

Nr-----date 16,02,2024

Mbeshtetur ne ligjin nr.139/2015 dt 17,12,2015 "Per vetqeverisjen vendore" dhe ligjet nr 94.2023,per titujt nderi
dhe titujt vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise Kryetari i Bashkise dhe Agjensia e
Arsimit,Kultures,Sporteve dhe Trashegimnise Kulturore i propozon Keshillit te Bashkise Peqin:

PROPOZIM

1-Te miratoje : **dhenjen e titujve te larte :"Qytetare Nderi"te Bashkise Peqin klerikeve te nderuar te Peqinit me motivacionin:Per kontributet e shquara ne mbrojtje te te drejtes se Besimit Islam"**

Z.Shyqyri Efendi Myftiut.1890-1946 Z.Shek Ahmet Gjinishi 1895-1968. Z.Ahmet Mezini 1915-

1978.Z.Hoshe Osmon Haskasa 1909-1977.Z.Myfti Efendi Qerim Behelulit 1895-1951. Z.Myfti Haxhi Hamit Hallulit 1917-2010

4-Ngarkohet me zbatim e ketij projekt-vendimi Kryetari I Bashkise dhe Agjensia e Arsimit, Kultures, Sportit
dhe Trashegimnise Kulturore

5-Ky vendim hyne ne fuqi pas konfirmimit ne prefekture.

KRYETARLI BASHKISE

Bukurosh MAGI




Shyqyri Efendi Myftiu 1890-1946

Patrioti, intelektuali dhe kleriku peqinas me vlera patriotike mbare kombetare . Shyqyri Efendi Myftiu u laurua me diplomen shkelqyeshem ne Kajro te Egjiptit per Teologji dhe –Drejtesi ne vitin 1918.Shyqyri Efendi Myftiu krahas detyrave te larta te deputetit te Peqinit ne vitet 1921-1922,te kryetarit te Bashkise Peqin , ai do te kryente dhe detyren e Nenkrytarit te Komunitetit Myslyman Shqiptare,ku humbi per nje vote me nje personalitet dhe patriot te shquar si Vehbi Dibra i cili u be kryetare i komunitetit Myslyman Shqiptare.Shyqyri efendi myftiu ishte nje nga organizatoret e Kongresit Mysliman Shqiptare ne vitin 1923 ku komuniteti Mysliman Shqiptare u shkeput nga She Ul Islami i Turqise dhe ku u vendos qe librat fetare te ishin ne gjuhen shqipe.Shyqyri Efendi Myftiu ishte nje nga perkthyeset tane me te mire ne gjuhet Persisht,Oismanisht ne vitet 1920-1940,ku shume libra nga keta dy gjuhe jane perkthyer nga ai,ku dhe sot konsiderohen nga perkthimet me te mira ne Shqiperi.Shyqeri Efendi Myftiu ne vitet 1927-1931 drejtonte si kryeredaktore dhe revisten prestigjoze "Zani i Nalte",ku krahas çeshtjeve teologjike ai me kurajo prej nje intelektuali trajtonte dhe shkrime me vlera kombetare dhe

shkencore. Shyqyri Efendi Myftiu nga vitet 1933-1944 punon dhe si avokat ne Peqin dhe Tirane. Shyqeri Efendi Myftiu eshte nje nga personalitetet e Besimit islam qe denohet me pushkatim nga regjimi komunist ne vitin 1946.

Konceptoi

Genc Gripshi



Sheh Ahmet Gjinishi 1895-1968

Kryeprijesi Rrifai Sheh Ahmet Gjinishi ishte patrioti, intelektuali dhe kleriku me vlera mbare kombetare. Ai ishte djali i patriotit dhe Kryeprijesit Rrifai Shejh Tasim Gjinishit i lauruar ne Stamboll per Teologji dhe –Drejtesi. Sheh Ahmet Gjinishi ishte kleriku patriot qe luftoi per konsolidimin e Shtetit Shqiptare. Sheh Ahmeti punoi si gjyqtare pajtues ne Peqin deri ne vitin 1938, se ne kete vit zgjidhet Kryeprijes i Asetanes Rrifai per te gjithe Shqiperine. Teqete e Asetanes Rrifai ne te gjithe Shqiperine ku qendren e kishin ne Peqin dhe nga viti 1700 drejtohej nga perfaqsues te shquar te fisit me emer Gjinishi, gjate kohes se Rilindjes Shqiptare u bene vatra te arsimit, shkolles, dhe gjuhes shqipe, si dhe te levizjeve per Pavaresi kombetare dhe konsolidimin e Shtetit Shqiptare. Kryeprijesi Rrifai Sheh Ahmet Gjinishi mbas ndalimit te fese nga regjimi komunist nuk e hoqi veshjen fetare dhe nuk doli me asnjehere ne publik deri sa nderroi jete.

Konceptoi

Genc Gripshi




Ahmet Mezini 1915-1978

Besimtari qe luftoi dhe sakrifikoi per nje nga ligjesite baze te njerezimit:E drejta e Besimit dhe u denua me nje gjyqje popullore dhe shembullore per te mbrojtur fene.Ahmeti lindi ne qytetin e Peqinit ne vitin 1915 ne nje familje te vjeter dhe te nderuar zejtaro-tregetare dhe fetare siç ishin Mezinet.Familja Mezini merej qe heret me prodhimet e sapunit,ku me vone ne vitet 1930-1950 merej me rrobaqepsi dhe me tregetimin e rrobave per veshje,ku krijuan dhe nje kompani Italo-Shqiptare dhe ku Ahmet Mezini u be nje nga rrobaqepesit me te mire te kostumeve ne Shqiperi.Familja Mezini per ti shpetuar perndjekjes,per shkak e te qenurit te pasur ne vitin 1950 vendoset me banim ne Durres,ku u moren perseri me rrobaqepsi dhe mbaheshin si mjeshtra ne stilimin e kostumeve me porosi.Ahmet Mezini nuk u pajtua me lufthen dhe zallamahine e regjimit komunist kunder feve,besimeve dhe objekteve te kultit qe kulmin e arriten ne vitin 1967.Ai gati per nje vit filloi te hidhte fletushka ne shkollat e mesme ne Durres per mbrojtje te besimit dhe fese islame si dhe xhamive qe veç objekteve te kultit ishin dhe monumente kulture.Ai ne keto fletushka sqaronte rinine qe po keqperdorej ne lufte kundra fese dhe i kundervihej propogandes antifetare te regjimit

komunist.Ahmet Mezini arrestohet,demaskohet ,keqtrajtohet dhe denohet me nje gjyqje popullore dhe shembullore me 10 vite burg si perhapes dhe propogandues i fese dhe besimit duke luftuar per nje te drejte legjitime te besimit.

Konceptoi

Genc Gripshi

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Genc Gripshi".

Myftiu Haxhi Efendi Qerim Beheluli 1895-1951

Myfti Haxhi Qerim Beheluli arsimimin e pare ne perkushtimin ndaj fese islame e mori ne familjen dhe fisin e tije Beheluli qe kishin nje tradite te hershme dhe te pasur islame.Qerim Beheluli mbasi mbaron me rezultate te larta mejtepin dhe medresen e Peqinit ndjek studimet per teologji ne Medresin e nalte te Manastirit.Myftiu Qerim Beheluli ishte nje drejtues fetare atdhetare ,si dhe nje mesues i mire i fese islame.Myftiu Haxhi EfendiQerim Beheluli ishte nje myfti me dimensione shpirterore dhe virtute islame dhe gezonte nje respekt te madh nga besimtaret dhe populli i Peqinit,dhe jo vetem.Myftiu Haxi effendi Qerim Beheluli ja kushtoi gjithe jeten e tije ngulitjes se bindjes tek njerezit se feja islame eshte dhe predikon: Serjozitetin dashurine,paqen,meshiren dhe njezerllikun.

Konceptoi

Genc Gripshi




Myftiu Haxhi Hamit Hallulli 1917-2010

Myftiu Haxhi Hamit Hallulli lauruar ne Medresen e Nalte te Tiranes u be simboli qendreses,i rezistences,dhe i besimtarit te mire,qe me dinjitet dhe kurajo perballoj kercenimet,keqtrajtimet dhe gjyqjet te inskenuara popullore.Myftiu Haxhi Hamit Hallulli dhe pse jetoi ne periudhen me te veshtire te fese islame kur ajo ishte e ndaluar me ligj,edhe pse e detyruan te punonte ne punet me te veshtira, perseri ai ne fshehtesi kryente ritet fetare dhe agjeroi dhe ne periudhen kur feja ishte e ndaluar dhe persekusioni ndaj klerikeve ishte i madh.Myftiu Haxhi Hamit Hallulli ishte nder te paret klerike qe riveshi uniformen e Islamit qe ne vitin 1990 dhe se bashku me Afiz Sabri Koçin,Hoxhe Xhaferr Shkodren hapi dyert e xhamive te para ne ShqiperiMyftiu Haxhi Hamit Hallulli per kontributet e tije per fene Islame u vlersua nga Komuniteti Mysliman Shqiptare me titullin :"Pishtare I lirise se Besimit".Myftiu Haxhi Hamit Halluli ishte nje nga Myftite me te perkushtuar ne Peqin mbas rihapjes se Besimit dhe Fese

Konceptoi

Genc Gripshi



Hoxhe Osmon Haskasa 190~~9~~-1977

Edhe pse regjimi komunist beri aktin me te pashembull per ndalimin e fese dhe besimin me ligj, hoxha i mire Osman Haskasa ne fshehtesi kryente ne zonen e Peqinit ritet fetare. Hoxha Osmon Haskasa si klerik mysliman gezonte nje emer te madh dhe nje adhurim nga besimtaret dhe populli i Peqinit dhe qyteteve fqinje per perkushtimin dhe baniresit e tija si drejtues fetare. Osman Haskasa ne moshen 66 vjeçare ne vitin 1971 arrestohet dhe burgoset me 5 vite burg se ushtronte besimin e tije me te cilin ishte rritur dhe kishte studiuar. Dhe ne burg oficerat e sigurimit i ngritten kurth qe ta ridephonin Hoxhe Osman Haskasan, por ai me mençurine e tije jo vetem qe nuk ra ne kurthin e kurdisur por e vuri dhe ne loje oficerin shpirt katil, ku dhei ajo shprehja e famshme qe u be lajm motiv popullore ne vitet 1970-1980: "Une jam Hoxhe Haskasa nga Peqini qe se haje me ate kokerr ulliri"

Konceptoi

Genc Gripshi

